

STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PradiumTech" Sh.p.k

Subjektet e mëposhtme,

- Shoqëria "Sestante Holding" SRL, subjekt i të drejtës italiane, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Milans, me numër regjistrimi dhe kod fiskal nr. 09885160961, me seli në adresën Via Cerva, n. 31, Milano, Itali, me përfaqësues ligjor zj. Enida Shehaj, e lindur më 28 Shtator 1987, në Librazhd, Shqipëri, dhe rezidente në Itali, e cila mban pozicionin e administrators së shoqërisë, me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BR4275811, lëshuar në datë 17.01.2014, e cila në këtë akt përfaqësohet me prokurë të posaçme nr. 3835 Rep., datë 08.02.2019, nga Orjon Nallbati, lindur në Korçë, në datë 02.02.1983, banues në Durrës, identifikuar me letërnjoftimin nr. 027999152;
- Ermal KRISTO, i biri i Kiços dhe Donikës, lindur më 17.01.1982, në qytetin e Përmetit, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, me zotësi juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 024462295, lëshuar nga Ministria e Brendshme, në datë 27.02.2009;
- Arjan YMERI, i biri i Frederikut dhe i Marjetës, lindur më 02.01.1980, në qytetin e Korçës, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, me zotësi juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me pasaportën nr. BA0995183, lëshuar nga Ministria e Brendshme, në datë 10.01.2011.
- Silvana Bala, e bija e Abdiut dhe e Makbules, lindur më 15.04.1959, në qytetin e Tiranës, banuese në Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare, me zotësi juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me letërnjoftimin nr. 031251871, lëshuar nga Ministria e Brendshme, në datë 02.08.2011.

në cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë, krijojnë:

Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "PradiumTech" Sh.p.k, me seli në Rruga "Bardhok Biba", Pall. "Trema Engeering 2", Përballë Nënstacionit, katë i II, Tiranë, Shqipëri.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "PradiumTech" sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Ortakët e kësaj shoqërie, janë:

- Shoqëria "Sestante Holding" SRL, e cila zotëron 65 % të kapitalit të kësaj shoqërie;
- Ermal KRISTO, i cili zotëron 5 % të kapitalit të kësaj shoqërie;
- Arjan YMERI, i cili zotëron 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie;

- Silvana Bala, e cila zotëron 10 % të kapitalit të kësaj shoqërie, të cilët sëbashku zotërojnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 2.1. Shoqëria mban emrin "PradiumTech" sh.p.k, dhe është person juridik shqiptar.
- 2.2. Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

- 3.1. Shoqëria "PradiumTech" sh.p.k, ka qendrën në adresën Rruga "Bardhok Biba", Pall. "Trema Engeering 2", Përballë Nënstacionit, katë i II, Tiranë, Shqipëri, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

- 3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësítë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

- 4.1. Qëllimi i shoqërisë është: Sherbime ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK). Konsulencë dhe menaxhim te projekteve. Dizenjim, implementim dhe mirembajtje te sistemeve. Sherbime auditimi te sistemeve, hostim infrastrukture dhe software, hostim i bazes se te dhenave, hedhje dhe perpunim te dhenash. Projektim, zhvillim, implementim, testim dhe mirembajtje te platformave dhe sistemeve software e hardëare qe perfshihen ne aktivitete ICT, ne te gjitha fushat e aktivitetit te biznesit, te menaxhimit, qeverisjes, prodhimit dhe cdo fushe tjeter aktiviteti ekonomik e shoqeror qe kerkon mbeshtetje nga procese dhe sisteme ICT, perfshire ato ne fushen e administrimit te aktiviteteve te biznesit, ne fushen e edukimit dhe te zgjidhjeve interaktive multimediale, ne fushat e punimeve topogjeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, sistemet e informacioneve gjeografike (GIS), pasurite e paluajtshme, ne fushen e biznesit financier e bankar, ne ate te sherbimeve te sigurimit te jetes, shendetit e pasurise, etj. Kurse te formimit profesional per platformat software per nivele te ndryshme (analist, perdorues, zhvillues, trajnues, etj.). Kurse te formimit profesional per sisteme ICT, aplikacione, menaxhim projektesh, menaxhim procesesh dhe cilesie. Dizenjimi grafik, zhvillim dhe mirembajtje e faqeve web. Sisteme monitorimi video. Sisteme dhe pajisje ICT te karakterit industrial dhe

per nevoja specifike te projekteve te rendesise se vecante. Import-eksport, dizenjim, prodhim, asemblim dhe aktivitet i tregtimit me shumice e pakice i pajisjeve te telekomunikacionit, informatikes, elektronikes, rrjetave kompjuterike, telefonise, pajisjeve te fuqise, pajisjeve te sistemeve te sigurise dhe akses kontrollit, kamerave, sistemeve video dhe audio, pajisjeve te transmetimit pa vale, kabllove te bakrit dhe kabllove optike. Import-eksport, shitje, implementim, integrim dhe mirembajtje e produkteve software apo sherbimeve te suportit te paleve te treta ne trajten e licensave software apo blerjes se sherbimeve periodike. Sherbime suporti teknik, shitje e marketing per pale te treta. Projektim, ndertim e mirembajtje qendrash te dhenash (data center), perfshire te gjithe elementet pasive e aktive te saj (sisteme, pajisje, software dhe elemente te tjere). Sherbime per data center dhe cloud. Operator i sherbimeve te telekomunikacionit per perdoruesit biznes dhe familjare: Ndertim Rrjetash publike dhe private (aksesi apo transmetimi) te komunikimeve elektronike tokesore fikse (me perçjellesa metalike, me fiber optike) ose me radio (wireless). Sherbime publike te komunikimeve elektronike (sherbimi i aksesit ne Internet, transmetimit te te dhenave. Studimi i tregut, i studimit te opinionit publik, matja e medias, paneli i konsumatoreve e auditimi i shitjeve me pakice, konsulenca e manaxhimi, sherbimi i reklamave e promocional, perpunimi i te dhenave, zhvillimi si dhe shitjet e programeve kompjuterike. Hulumtim i tregut dhe i opinionit publik. Hulumtimi imediave, si TV, RADIO, GAZETA apo Bilbordeve. Dhenie konsulence ne lidhje me tregtine, bussines-in dhe organizimii seminareve ne per to. Te sherbej si perfaqesuese shitje e marketingu, agjent shitje per Shoqeri vendase dhe te huaja, apo çdo gjëje tjetër që mund të nevojitet apo që mund të jetë me interes në lidhje me ushtrimin e çdo aktiviteti të ligjshëm.

4.2. Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të përbushë të gjitha levizjet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arrijen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të marrë përsipër interesa të tjera, kuota/ aksione, pjesëmarrje në kapitalet e shoqerive të tjera apo dhe kompani të cilat kanë aktivitet tjetër social direkt apo indirekt, pa pasur për qellim vendosjen tek palët e treta.

4.3. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe finanziar, të miratuar nga Ortaku/Ortakët e saj.

4.4. Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

NENI 5

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE TË SAJ

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakut të saj.



Kito Mësimi

5.2. Ortakët e kësaj shoqërie, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata kanë nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQËRISË

7.1. Shoqëria do të ketë vulën e saj "PradiumTech" sh.p.k.

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQËRISË

8.1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "PradiumTech" sh.p.k përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë, dhe është i ndarë në 4 (katër) kuota (më tej secila referuar si "Kuota", dhe së bashku "Kuotat").

8.2. Në datën e nënshkrimit të këtij Statuti, Shoqëria ka 4 (katër) Ortakë të cilët janë nënshkruar dhe zotëruan të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, dhe përfaqësojnë kapitalin e Shoqërisë sipas përqindjeve të mëposhtme:

- Shoqëria "Sestante Holding" SRL, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë lek) e cila përfaqëson 65 % të kapitalit të kësaj shoqërie;
- Ermal KRISTO, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 5.000 (pesë mijë lek) e cila përfaqëson 5 % të kapitalit të kësaj shoqërie;
- Arjan YMERI, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 20.000 (njëzet mijë lek) e cila përfaqëson 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie;
- Silvana Bala, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë lek) e cila përfaqëson 10 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

8.3 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

8.4. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortaku tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të të tretëve, kryhet gjithnjë me akt juridik të posaçëm.

9.2. Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogelojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

9.3. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet lëshimit të kuotave të reja, apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre do të paguhet plotësisht menjëherë me nënshkrimin e tyre, përveç kur parashikohet ndryshe në vendimin e Asamblesë.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre, nga ortakët e tjera të shoqërisë.

KREU III

NENI 11

ORGANI VENDIMMARRËS



Kristo
Hilmi
Fikri

11.1. Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë. Ortaku do të ketë të drejta vote në përpjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij.

11.2. Ortaku/ët i/e saj, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Në regjistrin e vendimeve, duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

11.5. Asambleja e Pergjitheshme do te mbahet ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend tjeter brenda ose jashtë Shqiperise ku Ortaket mund te bien dakord. Vendi i perzgjedhur, data dhe ora si dhe rendi i dites dhe dokumentat perkatese ne lidhje me mbledhjen duhet t'i njoftohen Ortakeve me ane te postes se regjistruar ose emailit te pakten 7 dite perpara dates se percaktuar per maledhjen.

11.6. Per cdo vendim te marre jashtë Shqiperise nje vendim i shkruar duhet t'i dergohet Administratorit te Shoqerise. Ne rastet kur Asambleja nuk eshte mbledhur sipas ketij Neni, atehere Asambleja mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe Ortaket jane dakord.

11.7. Çdo Ortak ka te drejte te përfaqësohet me prokure ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare. Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhje nepermjet mjeteve te komunikimit ne distance sic telekonferencat dhe/ose videokonferencat, etj.

11.8. Ortaket pranojne dhe jane dakort per te vendosur duke shprehur voten edhe ne



Handwritten signatures of the members of the Assembly are visible across the bottom of the page, above the page number '6'.

menyre te shkruar nepermjet qarkullimit te dokumentit te shkruar. Draft vendimi se bashku me rendin e dites dhe njoftimin dhe dokumentat mbeshtetese duhet t'i dergohet Ortakeve me poste, email ose mjete elektronike te sigurta te pakten 7 dite perpara dates se mbledhjes. Ortaket kane te drejte te miratojne vendimin duke derguar nje kopje te nenshkuar te projekt-vendimit tek Administratoret ne daten ose perpara dates se mbledhjes. Ortaket te cilet votojne kunder duhet te shprehin kundershtite e tyre per vendimin ne nje dokument me shkrim dhe duhet ta dergojne ate tek Administratori. Vendimi do te konsiderohet i miratuar nese kuorumi dhe shumica e kerkuar ne perputhje me kete Statut jane permbushur.

11.9. Çdo Ortak ka te drejten te votoje ne perputhje me, dhe ne proporcion me vleren nominale te Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

11.10. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum pjesemarrjeje prej me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 70% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- a. vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndryshem te fitimeve te Shoqerise;
- b. ndryshimi i Statutit i cili nuk lidhet me objektin e Shoqerise;
- c. zmadhimi i kapitalit me nje vlere nen 3 (tre) milion Euro ose zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

NENI 12

ADMINISTRATORI

12.1. Administratori i shoqërisë "PradiumTech" sh.p.k. është: Z. Arjan Ymeri.

12.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

12.3. Administratori i kësaj shoqërie ka të drejtë që, në ushtrim të kompetencave të administratorit, që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë çdo institucioni privat apo publik, si dhe të marrë të gjitha vendimet në interes të shoqërisë.

12.4. Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë ortakut.


12.5. Afati i emerimit per Administratorin eshte 5 (pese) vjet me te drejte rinnovimi. Çdo ndryshim i mepasshem ne lidhje me numrin ose personin e Administratorit/reve, nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;



- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

13.3. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet.

13.4. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimisht ortakëve.

13.5. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

13.6. Asambleja ka te drejte te shkarkoje Administratorin në cdo moment, me shumicë të thjeshtë.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyll më 31 Dhjetor.

NENI 15

BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët e shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga

A series of handwritten signatures in black ink, likely belonging to the Board members, are placed across the bottom right corner of the page. The signatures are fluid and vary in style, with some being more prominent than others.

Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e viti të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

MBARIMI I SHOQËRISË

16.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të hetet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Në këtë rast ortaku i shoqërisë merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqerise emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakut të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim më këtë nen është i pavlefshëm.

NENI 18

E DREJTA E PARABLERJES

18.1. Çdo transferim i kuotes se Shoqerise apo e një pjese te saj nga një ortak do te jetë objekt i te drejtës se parablerjes te ortakut tjeter (me tej e "Drejta e Parablerjes"). E Drejta e Parablerjes do te ushtrohet sipas kushteve te percaktuara me poshtë.

18.2. Nese secili ortak synon te transferoje, te shese ose te disponoje ne menyre tjeter kuoten e tij ne Shoqeri, ose pjesë te saj, (me tej "Ortaku Shites") tek nje pale e trete (e cila nuk eshte pjesë e nje nga Ortakeve ekzistues), (me tej "Pala e Trete Blerese") atehere ortakëve të tjera (me tej "Ortaku Jo Shites") do t'i ofrohet per shitje kuota ne Shoqeri ose pjesa e saj perpara se kjo t'i shitet Pales se Trete Blerese, me te nejftat kushte qe i eshte ofruar ose qe eshte negociuar me Palen e Trete Blerese.

18.3. Ortaku Shites do te dergoje nje njoftim (me tej "Njofimi i Shitjes") tek Ortaku Jo Shites. Njoftimi i Shitjes ne menyre te arsyeshme do te pershkruaje detajet ne vijim: (i) natyren e shitjes apo transferimit te propozuar, (ii) kuoten, apo pjesen e saj, e cila do te shitet apo transferohet, (iii) çmimin qe do te paguhet per kuoten apo pjesen e saj, (iv) identitetin e Pales se Trete Blerese dhe (v) cdo kusht dhe term material te propozimit per shitje. Njoftimi i Shitjes do te perbeje oferten per Ortakun Jo Shites, per te blere kuoten apo pjesen e saj te ciles i referohet. Oferta per blerje te kuotes apo te pjeses se saj, te pershkruar ne kete Nen do te qendroje ne fuqi dhe do te kete efekt 30 (tridhjete) ditor nga dita e dergimit te Njoftimit te Shitjes tek Ortaku Jo Shites.

18.4. Nese Ortaku Jo-Shites vendos te bleje kuoten ose pjesen e saj, me çmimin dhe kushtet e parashikuara ne Njoftimin e Shitjes, ai duhet te dergoje tek Ortaku Shites nje njoftim pranimi ("Njoftimi i Parablerjes") brenda afatit prej 30 (tridhjete) ditesh te percaktuar ne pikën 18.3 dhe finalizimi i shitjes do te ndodhe brenda 20 (njezet) ditesh nga dita kur Njoftimi i Parablerjes eshte marre nga Ortaku Shites.

18.5. Ne rast se Ortaku Jo-Shites nuk ushtron te Drejten e Parablerjes (si ne rastin kur nuk dergon Njoftimin e parablerjes brenda afatit ne 18.3 ose duke njoftuar per mos ushtrimin te se Drejtës se Parablerjes), atehere Ortaku Shites mund te shese kuoten e tij ne Shoqeri ose pjesen e saj, tek pala e Trete Blerese me kushte jo me pak te favorshme per Ortakun Shites se sa ato te ofruara ne fillim tek Ortaku Jo-Shites me ane te Njoftimit te Shitjes.

NENI 19

BAZA LIGJORE

19.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

19.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

NENI 20

MOSMARREVESHJET

20.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

20.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 21

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

21.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakut të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tij.


21.2. Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlere të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

21.3. Për regjistrimin e shoqërisë dhe akteve juridike pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, autorizohet përfaqësuesi me prokurë i ortakut Sestante Holding sh.p.k., av. Orjon Nallbati, i cili ka të drejtë të autorizojet dhe persona të tjera për kryerjen e çdolloj veprimi në QKB, pa pasur mundësi të tjerët të gjejnë të meta.

ORTAKËT THEMELUES:

Sestante Holding Srl
Administratori
ENIDA SHEHAJ
Përfaqësuar nga:
Orjon Nallbati


ERMAL KRISTO



ARJAN YMERI



SILVANA BALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Notere Elona A. SYLA

Nr. 568/Rep

2

VËRTETIM

Ne Tirane, sot, me date 07/03/2019 (Dymije e nentembëdhjetë) para meje Noteres Elona A. Syla, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën "Rr. Shyqyri Bërxolli", Pall. "Aurora", Kt.2, Tiranë, u paraqit personalisht:

1. Shoqeria "Sestante Holding" Srl, subjekt i te drejtes italiane, e rregjistruar ne Rregjistrin e Shoqerive te Milano me nr.rregjistrimi dhe kod fiscal nr.09885160961, me seli ne adresen Via Cerva, nr.31, Milano Itali, me perfaqesuese ligor Znj.Enida Shehaj, e datelindjes 28.09.1987, lindur ne Librazhd, Shqiperi dhe rezidente ne Itali, identifikuar me pasaporten me nr.BR4275811, me date leshimi 17.01.2014, e perfaqesuar nga **Av.Orjon Nallbati**, I datelindjes 02.02.1983, banues ne Durres, identifikuar me leternjoftimin me nr.027999152 ,ne cilesine e ortakut themelues te shoqerise **"PradiumTech" shpk**

2.Z.Ermal Kristo, i biri i Kiços , i datelindjes 17.01.1982, lindur ne Permet dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr.024462295,me date leshimi 27.02.2009, ne cilesine e ortakut themelues te shoqerise **"PradiumTech" shpk**

3.Z.Arjan Ymeri, i biri i Frederikut, i datelindjes 02.01.1980, lindur ne Korçë dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me pasaporten me nr. BA0995183, me date leshimi 10.01.2011, ne cilesine e ortakut themelues te shoqerise **"PradiumTech" shpk**

4.Znj.Silvana Bala, e bija e Abdiut , e datelindjes 15.04.1959, lindur dhe banuese ne Tirane, madhor me zotesi te plete dhe per te vepruar i identifikuar me leternjoftimin me nr.031251871, me date leshimi 02.08.2011, ne cilesine e ortakes themeluese te shoqerise **"PradiumTech" shpk**

Te cilet në cilësinë e ortakeve themelues të Shoqerise **"PradiumTech" shpk**. konfirmuan nënshkrimin e tyre ne Statutin e kesaj shoqerie, per krijmin e saj me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar, dhe une noteri pasi u binda për identitetin e tij nëpërmjet dokumentit individual që mbante me vete e vërtetoj atë sipas kompetencave që parashikon neni 128 i ligjit 110/2018 "Për noterinë".

